



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 19, Datë 18.02.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË
“RREGULLAT E PËRKOHSHME TË MEKANIZMIT BALANCUES”, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 193, DATË 24.11.2017.**

Në mbështetje të neneve 16, 98 dhe 100 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, gërma f) dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 18.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a. me anë të shkresës nr. 8531 Prot., datë 14.12.2018, bën me dije se ka evidentuar diferenca (humbje) në bilancin financiar nga aplikimi i mekanizmit balancues sipas “Rregullave të Përkohshme të Mekanizmit Balancues”, miratuar me vendimin e ERE-s Nr. 193, datë 24.11.2017.
- OST sha, bëri me dije se, këto humbje vijnë si pasojë e aplikimit të katër koeficientëve konform gjëndjes së sistemit (ACE) kundrejt pjesëmarrësve të tregut (BRP) dhe aplikimit të dy koeficientëve kundrejt Ofruesit të Shërbimit Balancues (BSP).
- OST sha kërkon rishikimin e aplikimit të këtyre koeficientëve nga ERE, duke mos paraqitur propozim konkret, por vetëm duke parashtruar se, hyrja në fuqi e Rregullave Definitive të Balancimit mund të shtrihet në kohë përgjatë vitit 2019, si dhe referuar rregullave në fuqi, ku këto diferenca që evidentohen që do të jenë subjekt i rregullimit tarifor nga ana e ERE.
- ERE me anë të shkresës nr. 791/1 Prot, datë 26.12.2018, solli në vëmendje të OST sha se, rregullat e balancimit të energjisë elektrike propozohen për shqyrtim dhe miratim në ERE nga OST sha, pas konsultimit me palët e treta dhe kërkoi të paraqesin propozime konkrete në lidhje me rishikimin e koeficientëve të vendosura në Mekanizmin Balancues.

- OST sh.a., në vijim me shkresën nr. 26/1, datë 14.01.2019 ka kërkuar rishikimin e “Rregullave të përkohëshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e ERE-s nr.193, datë 24.11.2017, duke propozuar:

Në nenin 12, pika 2, pas gërmës “c” të shtohet gërma “d”, me këtë përmbajtje:

- *Të dispeçuar për të reduktuar prodhimin e energjisë elektrike ose rritur konsumin si shërbim balancimi, do të paguajë me çmimin e llogaritur si HUPX DAM çmim të një ore specifike, të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWh të disbalancës.*

Në nenin 12, pika 3, pas gërmës “c” të shtohet gërmë “d” me këtë përmbajtje:

- *Të dispeçuar për të rritur prodhimin e energjisë elektrike ose të redukojë konsumin si shërbim balancimi që do të paguhet me çmimin e llogaritur si HUPX DAM çmim të një ore specifike, të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWh të disbalancës.*

- ERE, me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton rregullat e balancimit, mbështetur në parashikimet e nenit 98 të ligjit 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar.
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i ka ofruar ndihmë teknike OST sh.a. në lidhje me hartimin e Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin e Balancimit të Energjisë Elektrike, ndaj edhe çdo ndryshim të ardhëm të këtyre rregullave OST sh.a. duhet të konsultohet me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- Siguria ekonomiko financiare e OST sh.a. ka rëndësi të madhe për tregun energjistik, ndaj ERE e konsideron të përshtatshme hapjen e procesit të rishikimit të këtyre rregullave duke përfshirë në konsultime me të gjithë palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e propozimit të OST sh.a. për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohëshme të mekanizmit balancues të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e ERE-s nr.193, datë 24.11.2017, si më poshtë :

Në nenin 12, pika 2, pas gërmës “c” të shtohet gërma “d”, me këtë përmbajtje:

- *Të dispeçuar për të reduktuar prodhimin e energjisë elektrike ose rritur konsumin si shërbim balancimi, do të paguajë me çmimin e llogaritur si HUPX DAM çmim të një ore specifike, të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWh të disbalancës.*

Në nenin 12, pika 3, pas gërmës “c” të shtohet gërmë “d” me këtë përmbajtje:

- *Të dispeçuar për të rritur prodhimin e energjisë elektrike ose të redukojë konsumin si shërbim balancimi që do të paguhet me çmimin e llogaritur si HUPX DAM çmim të një ore specifike, të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWh të disbalancës.*

2. OST sha të kryejë simulimet dhe argumentimet përkatëse që faktojnë se koeficientet dhe propozimet për rishikim janë të drejtë, ti'a bëjë me dije si dhe të konsultojë propozimet me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë si dhe palët e interesit.
3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, aplikuesin, si dhe palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË

Adriatik BEGO